FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

# VITAMINE B6

**Tableta - 25 mg**
**Tretësirë për injeksion - 100 mg / 2 ml**
**(Piridoksinë klorhidrat)**

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.**
• Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
• Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
• Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
• Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në këtë fletëudhëzues:**

1. Çfarë është Vitamine B6 dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Vitamine B6
3. Si ta merrni Vitamine B6
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Vitamine B6
6. Informacion i mëtejshëm


## 1. ÇFARË ËSHTË VITAMINE B6 DHE PËRSE PËRDORET

Vitamina B6 (klorhidrati i piridoksinës) është vitaminë e tretshme në ujë. Në të vërtetë, me vitaminë B6 nënkuptohen tri komponime të ngjashme: piridoksina, piridoksali dhe piridoksamina, nga të cilat përdoret kryesisht piridoksina në trajtë klorhidrati. Piridoksina merr pjesë kryesisht në metabolizmin e aminoacideve, por edhe në metabolizmin e karbohidrateve dhe të yndyrnave. Ajo është e nevojshme edhe për formimin e hemoglobinës. Pamjaftueshmëria e piridoksinës është e rrallë te njerëzit sepse ajo është e pranishme në ushqime, megjithatë ajo mund të shkaktohet nga barnat, si p.sh. gjatë mjekimit me izoniazid. Pamjaftueshmëria e piridoksinës mund të shkaktojë anemi sideroblastike, dermatit, kielozë dhe simptoma neurologjike, si p.sh.: neurit periferik dhe konvulsione.

**Vitamine B6 indikohet në:**
- gjendjet që vijnë nga pamjaftueshmëria e piridoksinës;
- neuropatinë e shkaktuar nga izoniazidi;
- trajtimin e të përzierave ose të vjellave në periudhën e shtatzënisë;
- anemi sideroblastike idiopatike;
- hiperoksaluri të tipit I;
- helmimet me hidrazinë;
- profilaksinë e të vjellave nga eteri.

## 2. PËRPARA SE TË MERRNI VITAMINE B6

Mos merrni Vitamine B6 në qoftë se jeni i ndjeshëm ndaj klorhidratit të piridoksinës ose ndaj ndonjërit nga përbërësit e tjerë të tabletës ose të tretësirës për injeksion.
Administrimi i Vitamine B6 në rrugë intravenoze në pacientët me patologji kardiake duhet të evitohet.

**Tregoni kujdes të veçantë me Vitamine B6**
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Vitamine B6!
Piridoksina ekskretohet në qumështin e gjirit dhe mund të frenojë laktacionin.
Siguria dhe efektshmëria e piridoksinës tek fëmijët nuk është përcaktuar në dozat që tejkalojnë kërkesat ushqimore.
Pacientët të cilët trajtohen me levodopa nuk duhet të marrin njëkohësisht Vitamine B6. Ky kufizim nuk është i nevojshëm nëse levodopa shoqërohet me një frenues të dopa-dekarboksilazës.

**Marrja e barnave të tjera**
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Vitamine B6. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Vitamine B6 në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:
- levodopa, sepse piridoksina i ul efektet e saj nëse administrohet në doza të larta, por kjo gjë nuk ndodh nëse levodopa shoqërohet me një frenues të dopa - dekarboksilazës;
- fenobarbital ose fenitoinë, sepse piridoksina ul përqëndrimet e tyre në serum;
- izoniazid, hidralazinë, penicilaminë, kontraceptivë oralë, sepse këto barna mund t'i rrisin kërkesat për piridoksinë;
- altretaminë, sepse piridoksina ul veprimin e saj.

**Shtatzënia**
Kategoria C (A).
Vitamine B6 mund të administrohet në sasi të cilat i korrespondojnë nevojave ditore.
Megjithëse deri më sot nuk njihen pasoja të rënda, ky bar nuk duhet të përdoret gjatë shtatzënisë, përveçse në rastin kur përfitimi potencial e tejkalon riskun ndaj të cilit ekspozohet fetusi.
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar!

**Ushqimi me gji**
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar!
Vitamine B6 (klorhidrati i piridoksinës) ekskretohet në qumështin e gjirit dhe mund të frenojë laktacionin.
Nuk duhet përdorur gjatë ushqimit me gji përveçse në rastin kur përfitimi potencial e tejkalon riskun ndaj të cilit ekspozohet fëmija.

**Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive**
Nuk ka të dhëna se ky bar ndikon mbi aftësinë për të drejtuar automjetin dhe për të përdorur makineri.

**Informacion i rëndësishëm për disa nga përbërësit e Vitamine B6**
Tabletat Vitamine B6 përmbajnë laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj se vuani nga intoleranca ndaj disa sheqernave, flisni me mjekun përpara se të merrni këtë bar.

## 3. SI TA MERRNI VITAMINE B6

Gjithmonë përdoreni Vitamine B6 sipas këshillës së mjekut!
Në qoftë se nuk jeni të sigurtë, kontaktoni me mjekun ose farmacistin.
Në qoftë se ndjeni që efektet e Vitamine B6 janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.
Dozimi bëhet si vijon:
• në gjendjet që vijnë nga pamjaftueshmëria e vitaminës B6 (piridoksinës):
nga goja dhe me injektim nën lëkurë: 20 - 50 mg deri 3 herë në ditë;
• në neuropatitë nga izoniazidi:
nga goja: 12.5 mg në ditë (profilaksi); 50 mg, 3 herë në ditë (mjekim);
me injektim në muskul ose në venë ose nën lëkurë: 50 deri në 200 mg në ditë;
• në anemitë sideroblastike idiopatike:
nga goja ose me injektim në muskul apo në venë ose nën lëkurë: 50 – 100 mg në ditë;
• në profilaksinë e të vjellave nga eteri:
me injektim në muskul: 100 mg, 20 minuta para fillimit të anestezisë së përgjithshme.

**Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamine B6**
Në qoftë se keni marrë më shumë Vitamine B6 se sasia që duhet të merrnit, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin, ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

**Në qoftë se harroni të merrni Vitamine B6**
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Vitamine B6 mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.
Pjesa më e madhe e efekteve anësore janë të lidhura me dozën dhe zhduken kur doza reduktohet ose trajtimi ndërpritet. Disa efekte anësore mund të ndodhin në fillim të trajtimit dhe zhduken në mënyrë spontane me vazhdimin e mjekimit.
Efektet e padëshiruara që mund të japë Vitamine B6 janë si më poshtë:
- përdorimi afatgjatë i dozave të larta të Vitamine B6 shoqërohet me neuropati periferike serioze;
- ecje të pasigurtë;
- përgjumje;
- mpirje të këmbëve;
- parestezi;
- nivele të ulëta të acidit urik;
- ataksi dhe reaksion fotoalergjik.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 5. SI TA RUANI VITAMINE B6

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Vitamine B6 pas datës së skadencës e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani në temperaturë mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita.

## 6. INFORMACION I MËTEJSHËM

**Çfarë përmban Vitamine B6 – Tableta 25 mg**
**Lënda vepruese** është piridoksinë klorhidrat (vitaminë B6).
Çdo tabletë përmban 25 mg piridoksinë klorhidrat.
**Përbërësit e tjerë janë:** laktozë, celulozë mikrokristalore, talk dhe stearat magnezi.

**Çfarë përmban Vitamine B6 – Tretësirë për injeksion 100 mg / 2 ml**
**Çdo ampulë 2 ml përmban** 100 mg piridoksinë klorhidrat.
**Përbërësit e tjerë janë:** acid klorhidrik (mund të shtohet për rregullim pH), ujë për injeksion.

**Përmbajtja e paketimit**
Tabletat: kuti me 10 tableta, kuti me 60 tableta.
Tretësira për injeksion: kuti me 10 ampula
kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

**Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:**

Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Përmbajtja. ! Kujdes.

Tretësirë për injeksion - Ampula

Tableta

**Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:**

**PROFARMA Sh.a.**
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Qershor 2015.

SPECIFICATION

CROPING AREA 12 X 19 cm

**PAY ATENTION**, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.